



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS

DEKANATI

Nr. 330 Prot

Tiranë, më 13. 09 -2021

**V E N D I M**

Nr. 40 Datë 13.09.2021

Dekanati i Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, pasi u njoh me Vendimet e Departamentit të Arkitekturës, Departamentit të Urbanistikës dhe Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës për kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar për punësimin e stafit akademik me kohë të pjesshme për secilin departament gjatë vitit akademik 2021-2022,

**V E N D O S I**

Të miratojë kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar për punësimin e stafit akademik me kohë të pjesshme për secilin departament gjatë vitit akademik 2021-2022.

Bashkëlidhur këtij dokumentacioni gjenden:

Vendimi i Departamentit të Arkitekturës

Vendimi i Departamentit të Urbanistikës

Vendimi i Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DEKANI**

**Prof. Asoc. Armand VOKSHI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**  
DEPARTAMENTI I URBANISTIKËS

*Tiranë, më 09.09.2021*

**V E N D I M**

Nr. 13 Datë 09.09.2021

**“KRITERET PËR PRANIMIT E PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME NË DEPARTAMENTIN E URBANISTIKËS, PËR VITIN AKADEMIK 2021 - 2022, FAU”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 57, pika 2;

Bazuar në Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 42, pika 3, pika 10;

Bazuar në Udhëzimin e MASR, nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngakesën mësimore të personelit akademik në IAL”;

Bazuar në Vendimin e UPT, nr.116, dt. 22.09.2020 “Miratimin e procedurës për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme në UPT”;

Për zhvillimin e procesit të pranimit të personelit akademik me kohë të pjesshme (PAK) në Departamentin e Urbanistikës, për vitin akademik 2021 - 2022, Asambleja e Departamentit më datë 07.09.2021, në rishikimin e kriterëve për personelin akademik me kohë të pjesshme,

**V E N D O S I**

Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët për personel akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e Urbanistikës për vitin akademik 2021 - 2022, FAU, UPT janë si vijojnë:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.

Departamenti i Urbanistikës pasi ka plotësuar detyrimisht ngarkesën e lejuar të stafit akademik efektiv (PAE) sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngakesën mësimore të personelit akademik në IAL”, dhe në respektimin e numrit total të personelit akademik me kohë të pjesshme të miratuar në Bordin e Administrimit për njësinë përkatëse, ka përcaktuar kriteret për personel akademik me kohë të pjesshme.

**FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**

Adresa: Rruga “Muhamet Gjollësja”, 54, Tiranë ,  
Tel/Fax: +355 (4) 2229045,  
www.fau.edu.al info@fau.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**  
DEPARTAMENTI I URBANISTIKËS

**Kriteret për pranim të stafit akademik të ftuar:**

- A. Kandidatët duhet të kenë përfunduar studimet e plota universitare brenda ose jashtë vendit. Diplomati e fituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga MASR.
- B. Të kenë përfunduar studimet e larta të të dy cikleve apo të ciklit të integruar, në profilin Urbanistikë/Arkitekturë, ose një profil të përputhshëm me lëndën në të cilën kandidojnë. Kandidati duhet të ketë një notë mesatare të përgjithëshme të ponderuar të studimeve të larta së paku 75/100. Preferohet mesatarja e lëndëve të specialitetit, lidhur me lëndën ku synohet të angazhohet, të jetë mbi 8.5.
- C. Preferohet që kandidatët të zotërojnë gradën Doktor i Shkencave, ose të jenë në proces të mbrojtjes së Doktoraturës në fushën e Urbanistikës ose të Arkitekturës.
- D. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj, të mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshminë/certifikatën përkatëse. Gjuhët e preferuara: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht.
- E. Preferohet që kandidatët të kanë kryer kurse dhe kualifikime të mëtejshme, si dhe të kenë bërë publikime brenda ose jashtë vendit, në fushën e specialitetit ku synon të angazhohet.
- F. Kandidatët duhet të kenë 3 vite pune eksperiencë, pas përfundimit të studimeve të larta.

**Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim duhet të përmbajë:**

- 1. Kërkesë me shkrim për aplikim, ku të citohen dhe lëndët ku kandidati konkurren (jo më shumë se 5 (pesë) lëndë – kërkesat pa lëndë të specifikuar, nuk do të merren në shqyrtim);
- 2. Jetëshkrimi (CV);
- 3. Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
- 4. Fotokopje e diplomës universitare dhe listës së notave të noterizuara (për diplomati e marrë jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit);
- 5. Formular vetëdeklarimi sipas shtojcës nr.01 bashkëlidhur;
- 6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton titujt dhe gradat, trajnime, kualifikimet, publikimet, arsimin shtesë etj. (nëse ka);
- 7. Rekomandime (Në rast se kërkohet nga njësia bazë)

FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësia", 54, Tiranë ,  
Tel/Fax: +355 (4) 2229045,  
www.fau.edu.al info@fau.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**  
**DEPARTAMENTI I URBANISTIKËS**

Personeli akademik me kohë të pjesshme duhet t'i nënshtrohet procedurës së konkurimit në çdo vit të ri akademik. Për plotësimin e dokumentacionit përjashtim bëjnë ish staf akademik i UPT, stafi i IGJEUM si dhe pedagogët e angazhuar me kohë të pjesshme në njësitë përkatëse më shumë se 2 (dy) vite radhazi. Këto kategori duhet të depozitojnë vetëm një kërkesë pranë Departamentin e Urbanistikës, FAU.

Kandidati për personel akademik me kohë të pjesshme, duhet të dorëzojë dosjen për aplikim në Departamentin e Urbanistikës, FAU, sipas miratimit dhe shpalljes që do të bëhet nga Dekani i FAU-t.

Komisioni *ad hoc* i vlerësimit përbëhet nga personel akademik i Departamentit të Urbanistikës, FAU:

- |                                                   |         |
|---------------------------------------------------|---------|
| ○ Drejtuesi i njësisë bazë                        | Kryetar |
| ○ Drejtuesi i grupit/grupeve mësimore - kërkimore | Anëtar  |
| ○ Titullarët e lëndëve spas fushave përkatëse     | Anëtar  |

**Vlerësimi i kandidatëve për personel akademik me kohë të pjesshme**

Vlerësimi i kandidatëve do të bazohet në vlerësimin e dosjeve të dorëzuara për aplikim dhe intervistën para komisionit:

- Vlerësimi i dosjes për aplikim (60 %)
- Vlerësimi i intervistës para komisionit të vlerësimit (40%)

Pas shqyrtimit të dosjeve dhe intervistave në Departamentin e Urbanistikës, do të përpilohet lista me kandidatët të renditur sipas pikëve përkatëse dhe do të publikohet sipas procedurave në Vendimin e UPT, nr. 116, dt. 22.09.2020 "Miratimin e procedurës për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme në UPT.

Bashkëlidhur gjendet:

- Shtojca nr.1 - Lista e lëndëve ku konkurrohet për personel akademik me kohë të pjesshme
- Shtojca nr.2 - Formular vetëdeklarimi

**FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësja", 54, Tiranë ,  
Tel/Fax: +355 (4) 2229045,  
www.fau.edu.al info@fau.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**  
DEPARTAMENTI I URBANISTIKËS

Për specifikat që kanë organizimet e grupeve të seminarit në lëndët studio/atelier, dhe duke mos patur ende numrin e saktë të studentëve për secilin vit studimi (ende nuk ka përfunduar sezoni i provimeve të vjeshtës 2021), për momentin nuk është e mundur të saktësohet se sa është numri i personelit akademik me kohë të pjesshme që nevojitet për secilën lëndë. Në këto kushte do të përpilohet dhe do të publikohet lista me kandidatët të renditur sipas pikëve përkatëse. Për numrin e saktë të personelit PAK dhe listën e fituesve do t'jua bëjmë të ditur sapo të ketë mbaruar procesi i provimeve i sezonit të vjeshtës 2021..

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

DREJTUESI I DEPARTAMENTIT TË URBANISTIKËS

**Dr. Julljan VELESHNJA**

FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësja", 54, Tiranë ,  
Tel/Fax: +355 (4) 2229045,  
[www.fau.edu.al](http://www.fau.edu.al) [info@fau.edu.al](mailto:info@fau.edu.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS  
DEPARTAMENTI I URBANISTIKËS

**Shtojca 1**

Lista e lëndëve ku konkurrohet për personel akademik me kohë të pjesshme, pranë DU

| Nr | M.Sh. |     | Semestri | Lënda                                                                                                                                      |
|----|-------|-----|----------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1  | URB   |     | 2        | Analizë qyteti dhe territori                                                                                                               |
| 2  | URB   | ARK | 4        | Bazat e projektimit urban dhe elemente të peizazhit                                                                                        |
| 3  | URB   | ARK | 6        | Urbanistikë 1                                                                                                                              |
| 4  | URB   |     | 7/8      | Projektim i mjedisit të ndërtuar                                                                                                           |
| 5  | URB   | ARK | 7        | Histori urbanistike                                                                                                                        |
| 6  | URB   |     | 7        | Planifikim territori                                                                                                                       |
| 7  | URB   | ARK | 7/8      | Projektim urbanistik 2                                                                                                                     |
| 8  | URB   | ARK | 7/8/10   | Legjislacion arkitektonik e urban                                                                                                          |
| 9  | URB   |     | 7        | Gjeografi urbane                                                                                                                           |
| 10 | URB   |     | 8        | Transport infrastrukture                                                                                                                   |
| 11 | URB   |     | 8        | Lëndë me zgjedhje 1:<br>Sociologji urbane<br>Politika urbane dhe territoriale<br>Kërkim shkencor dhe etikë profesionale                    |
| 12 | URB   |     | 8/9      | Menaxhim Urban                                                                                                                             |
| 13 | URB   |     | 9        | Elemente peizazhi                                                                                                                          |
| 14 | URB   |     | 9        | Projektim Urbanistik 3 (Rivitalizim Urban)                                                                                                 |
| 15 | URB   |     | 9        | Lëndë me zgjedhje 2:<br>Politikat e Strehimit<br>Teori Bashkëkohore të urbanizimit<br>Qyteti bashkëkohor: ndryshimet dhe politikat sociale |
| 16 | URB   |     | 10       | CAAD + Sisteme Informacioni (G.I.S)                                                                                                        |
| 17 |       | MJD | 6        | Planifikim Urban                                                                                                                           |
| 18 |       | FIN | 6        | Urbanistikë                                                                                                                                |
| 19 |       | FIN | 8        | Njohuri mbi planifikimin dhe projektin urbanistik                                                                                          |

FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësja", 54, Tiranë ,  
Tel/Fax: +355 (4) 2229045.  
www.fau.edu.al info@fau.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS  
DEPARTAMENTI I URBANISTIKËS

**Shtojca 2**

**FORMULAR VETËDEKLARIMI**

**Të dhënat e vetëdeklaruesit:**

|                                                                          |  |
|--------------------------------------------------------------------------|--|
| <u>Mbiemri, Emri</u>                                                     |  |
| <u>Atësia/Amësia</u>                                                     |  |
| <u>Datëlindja</u>                                                        |  |
| <u>Vendlindja</u>                                                        |  |
| <u>Dokumenti i identifikimit</u><br>(një kopje bashkëngjitur formularit) |  |

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: ☐ i/e padënuar, ☐ i/e dënuar

**DEKLARUESI**

**MARRËSI I VETËDEKLARIMIT**

Emri Mbiemri Firme

Emri Mbiemri Firme Vule

**Autorizim:** Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga \_\_\_\_\_

Subjekti i autorizuar

Nenshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nenshkrimit

**Shënim:** Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 8517 datë 22.07.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

**FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësia", 54, Tiranë ,  
Tel/Fax: +355 (4) 2229045,  
www.fau.edu.al info@fau.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**  
**DEPARTAMENTI I RESTAURIMIT DHE TEKNOLOGJISË SË ARKITEKTURËS**

Tiranë, 09.09.2021

**Lënda:** Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit, për personelin akademik me kohë të pjesshme, pranë Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës, për vitin akademik 2021-2022

**VENDIM Nr. 1**

Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës, në mbledhjen e datës 09.09.2021, vendosi:

**Kriteret për vlerësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2021-2022, si më poshtë vijon:**

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet Master Shkencor (ekuivalent me të) në Arkitekturë, ose të afërt me të, me notë mesatare mbi 7.5. Kandidatët preferohen, të kenë notë mesatare mbi 9, në grup-lëndët e disiplinave ku kërkojnë të kontribuojnë.
2. Kandidati duhet të ketë eksperiencë në mësimdhënie, ose në profesion, në specialitetin, apo fusha të ngjashme me disiplinat ku aplikojnë, për të kontribuar si personel akademik me kohë të pjesshme.
3. Preferohen kandidatët që zotërojnë gradën shkencore doktor, ose që janë të përfshirë në procesin e përgatitjes së tezës së Doktoratës në fushën e Arkitekturës (preferohen studentët e shkollës së Doktoraturës në FAU).
4. Preferohen kandidatët që kanë kryer kurse, kualifikime, apo që kanë bërë publikime brenda ose jashtë vendit, në fushën e specialitetit përkatës dhe që zotërojnë të paktën një gjuhë të huaj, të mbrojtur dhe të vërtetuar me dëshmi.

**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE  
URBANISTIKËS**

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësja", Nr.54, Tiranë,  
Tel/Fax: +355(4)2229045,  
web: www.fau.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**  
**DEPARTAMENTI I RESTAURIMIT DHE TEKNOLOGJISË SË ARKITEKTURËS**

**Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatet për personelin akademik me kohë të pjesshme:**

1. Letër motivimi (specifike për çdo aplikim)
2. Dokument identifikimi
3. C.V. e përgjithshme e përqendruar (*short-bio*, jo më e gjatë se një faqe), *portfolio* e punëve dhe kopje e botimeve/publikimeve
4. Diploma dhe lista e notave (kopje e noteruar)
5. Dëshmi e gjuhëve të huaja që zotëron
6. Dy letra reference nga persona me grada, tituj shkencorë, apo me eksperiencë në mësimdhënie në arsimin e lartë

**Vlerësimi i kandidatëve për personelin akademik me kohë të pjesshme:**

Komisioni *ad-hoc* i vlerësimit, i ngritur pranë Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës, që përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, drejtuesi i departamentit, drejtuesi i lëndës, mësimdhënësi i lëndës (apo lëndëve të ngjashme), bën vlerësimin e kandidatëve, si më poshtë vijon:

- Vlerësimi i përmbajtjes së dosjes së dorëzuar nga kandidati (60 %)
- Vlerësimi i kandidatit, përmes një interviste nga komisioni *ad-hoc* i vlerësimit (40 %)

Në përfundim të procesit, komisioni *ad-hoc* i vlerësimit, liston kandidatët në rend zbritës dhe kjo listë shërben për plotësimin e vendeve vakante për mësimdhënie në lëndën përkatëse.

**Anëtarët e Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës:**

Dr. Entela Daci

Dr. Loreta Çapeli

Dr. Etleva Bushati

Dr. Endrit Tuzi

Dr. Marsida Tuxhari

Dr. Jonida Mëniku

MSc. Lllazar Shyti

MSc. Andronira Burda

**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE  
URBANISTIKËS**

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësja", Nr.54, Tiranë,  
Tel/Fax: +355(4)2229045,  
web: [www.fau.edu.al](http://www.fau.edu.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**  
**DREJTUESI I DEPARTAMENTIT**

Tiranë 10.09.2021

Nr 1

**VENDIM**

Departamenti i Arkitekturës, në mbledhjen e datës 10.09.2021 vendosi:

**Kriteret për pranim të personelit akademik me kohë të pjesshme:**

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet Master Shkencor (ekuivalent me të) në profilin Arkitekturë, ose të afërt me të, me notë mesatare mbi 7.5. Kandidatet preferohen me mesatare mbi 9 në lëndët e disiplinave ku kërkojnë të kontribuojnë, ose të kenë aktivitet të spikatur profesional në fushën përkatëse.
2. Preferohen kandidatet që zotërojnë gradën doktor ose të jenë në proces të mbrojtjes së Doktoraturës në fushën e Arkitekturës (preferohen studentët e shkollës së Doktoraturës në FAU)
3. Preferohen kandidatët që kanë kryer kurse, kualifikime, apo që kanë bërë publikime brenda ose jashtë vendit, në fushën e specialitetit përkatës dhe që zotërojnë të paktën një gjuhë të huaj të mbrojtur dhe vërtetuar me dëshmi
4. Preferohen kandidatë me eksperiencë në mësimdhënie, në specialitetin apo fusha të ngjashme me disiplinat ku aplikojnë, për të kontribuar si personel akademik me kohë të pjesshme.

**Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatet për personelin akademik me kohë të pjesshme:**

1. Letër motivimi (specifike për çdo aplikim)
2. Dokument identifikimi
3. C.V. e përgjithshme e përqendruar (*short-bio*, jo më e gjatë se një faqe), *portfolio* e punëve dhe kopje e botimeve/publikimeve
4. Diploma dhe lista e notave (kopje e noteruar)
5. Dëshmi e gjuhëve të huaja që zotëron
6. Dy letra reference nga persona me grada, tituj shkencorë apo me eksperiencë në mësimdhënie në arsimin e lartë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS

DREJTUESI I DEPARTAMENTIT

**Vlerësimi i kandidatëve për personelin akademik me kohë të pjesshme:**

Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë: drejtuesi i departamentit, drejtuesi i lëndës, mësimdhënës i lëndës (apo të lëndëve të ngjashme)

- Vlerësimi i përmbajtjes së dosjes së dorëzuar nga konkurenti (60 %)
- Vlerësimi i konkurrentit përmes një interviste në komisionin e vlerësimit (40 %)

Në përfundim të procesit, komisioni liston kandidatët në rend zbritës dhe kjo listë shërben për plotësimin e vendeve vakante për mësimdhënie në lëndën përkatëse

**Drejtues i Departamentit të Arkitekturës:**

**Dr. Denada VEIZAJ**